

**STATUT
I QENDRËS
“BARAZI DHE PËRFSHIRJE”**

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil të RSH, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” i ndryshuar, Aktit të Themelimit të Qendrës, me vullnet të lirë të themelueses:

THEMELUESE:

Nadia ÇOBO, e dtl. 06.03.1997, lindur në Berat dhe banuese në në Berat, me adresë Muzhakaj 00010335; Nd. 14; H. 1; 5001; shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) numër personal J75306050I, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) numër personal J75306050I, hartohej ky statut i **Qendrës “BARAZI DHE PËRFSHIRJE”** dhe në anglisht “Center for Equality and Inclusion”, i cili përcakton rregullat dhe mënyrat e funksionimit të Qendrës gjatë veprimtarisë të saj.

Neni 1

Forma e organizimit dhe vizioni

Sipas mënyrës së organizimit kjo Organizatë Jofitimprurëse është një e tillë pa anëtarësi, vendase, e llojit Qendër, e themeluar sipas dispozitave të Kodit Civil të RSH, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i ndryshuar dhe Ligjit nr. 8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” i ndryshuar. Ajo është themeluar me vullnetin e lirë e të plotë të themelueses së saj dhe do të zhvillojë veprimtarinë në të mirë dhe interes të publikut.

Qendra është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur nga partitë politike dhe organet shtetërore. Qendra “Barazi dhe Përfshirje” synon të kontribuojë për një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe të barabartë ku grupet e marginalizuara gëzojnë efektivisht të drejtat e njeriut dhe ku çdo individ, në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat kanë mundësinë të arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe pa diskriminim.

Neni 2

Emri, sigla dhe simboli i veçantë

Emri i Qendrës është “Barazi dhe Përfshirje” dhe në anglisht Center for Equality and Inclusion. Qendra do të ketë siglën dhe simbolin e saj të veçantë e cila do të identifikojë çdo dokument që i përket asaj si dhe në çdo korrespondencë që ajo do të ketë me të tretët.

Sigla dhe simboli i veçantë përmban tre ilustrime të individëve nga grupe të ndryshme të marginalizuara, ilustruar në ngjyrat lejla dhe blu, në fushë të bardhë. Ata janë vendosur pranë njëri-tjetrit duke krijuar një ide të bashkëpunimit, solidaritetit dhe mbështetjes, për të garantuar të drejtat e njeriut të çdo individi. Kombinimi i ngjyrës lejla dhe blu, në fushë të bardhë simbolizon harmoninë, paqen dhe një shoqëri që punon për respektimin e të drejtave të njeriut. E paraqitur me grafikën si më poshtë:





Qendra do të ketë vulën e saj, e cila do të ketë formë drejtkëndëshe dhe do të përbëhet nga simboli dhe emri i Qendrës në shqip dhe në anglisht, e paraqitur grafikisht si më poshtë:



Neni 3

Personaliteti juridik

Qendra fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në Ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” dhe Ligjet nr. 8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”.

Qendra, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjës ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë të saj.

Personaliteti juridik i Qendrës mbaron në ditën kur vendimi i Gjykatës për çregjistrimin të saj merr formë të prerë.

Neni 4

Themelues

Themeluese e Qendrës është:

Nadia ÇOBO, e dtl. 06.03.1997, lindur në Berat dhe banuese në në Berat, me adresë Muzhakaj 00010335; Nd. 14; H. 1; 5001; shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) numër personal J75306050I, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) numër personal J75306050I.

Neni 5

Selia

Qendra e ka selinë në adresën Rruga “Bulevardi Zogu i Parë”, Nd. nr. 55/1, Ap.14, Tiranë, Shqipëri.

Me vendim të Bordit të Drejtoreve, Qendra mund të hapë degë të saj dhe të emërojë përfaqësues edhe në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

Qëllimi i Qendrës është:

Mbështetja, ndihma, edukimi ligjor, fuqizimi i qytetarëve, në mënyrë të veçantë qytetarëve nga grupet e marginalizuara dhe grave e vajzave nga këto grupe, me qëllim që të rritet aksesi i tyre në institucionet publike dhe në sistem, në mënyrë të veçantë, në sistemin e drejtësisë, forcimit të kapaciteteve të profesionistëve, analizave, publikimeve, lobimit, advokacisë, fushatave informuese e ndërgjegjësuese, rrjetëzimit, etj., duke siguruar që të drejtat e tyre janë respektuar dhe barazia dhe mos diskriminimi është siguruar, përmes:

- Njohjes së standardeve ndërkombe të mbi të drejtat e njeriut për qytetarët, me përparësi grupet e marginalizuara, barazinë, barazinë gjinore dhe mos diskriminimin;
- Informimit, Edukimit dhe edukimit ligjor me qëllim njohjen dhe ushtrimin e të drejtave dhe mjeteve ligjore nga qytetarët, në mënyrë të veçantë qytetarëve dhe grave nga grupet e marginalizuara;
- Ndihmës juridike falas për qytetarët;
- Mbështetjes dhe fuqizimit në përdorimin e teknologjisë, me qëllim gjëzimin e të drejtave dhe aksesimin e sistemit, përfshirë sistemin e drejtësisë;
- Fushatave të edukimit dhe ndërgjegjësimit për të drejtat e njeriut dhe si ti ushtrojnë ato në të gjitha fushat në mënyrë të veçantë në arsim, punësim, shëndet, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe jetën politike, të drejtat pronësore, parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, barazinë gjinore, aksesin në ujë të pijshëm, energji, kontributin për paqe dhe një shoqëri pa konflikte dhe mosmarrëveshje, klimën, energjinë, luftimin e varfërisë, dhe mos diskriminimin në të gjitha fushat;
- Monitorimeve të efektivitetit të sistemit, me fokus në vlerësimin e gjëzimit de facto të të drejtave nga qytetarët;
- Ndërmarrjes së nismave për përmirësimin e legjislacionit në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë, barazisë gjinore dhe mos diskriminimit;
- Advokimit në nivel qendoror dhe vendor me qëllim që prioritetet e grupeve të marginalizuara, në mënyrë të veçantë grave nga këto grupe, të jenë pjesë e politikave, planeve të veprimit dhe buxheteve të përgjegjshme përfshirëse dhe gjinore, në nivel qendoror dhe vendor;
- Forcimit të kapaciteteve të profesionistëve të sistemit, në nivel qendoror dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në zbatim të kuadrit ligjor dhe të drejtave të grupeve të marginalizuara, në mënyrë të veçantë grave nga këto grupe;
- Përgatitjes së raporteve, analizave, studimeve, përfshirë raportet për mekanizmat ndërkombe të konventave për të drejtat e njeriut dhe mos diskriminimin;
- Rrjetëzimit me organizata që punojnë në të njëjtën fushë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombe;

Target grupet e shoqërisë në fokus të veprimtarisë së organizatës janë:

- Qytetarët;
- Komuniteti rom dhe egjyptian, në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat nga ky komunitet;
- Persona me aftësi të kufizuara, në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat;
- Qytetarë që përballen me diskriminim, në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat;
- Komuniteti LGBTIQA+
- Gratë dhe vajzat rurale, nëna të vetme, gra të divorcuara;



- Gratë dhe vajzat që përballen me forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe dhunë në familje;
- Gra dhe vajza që përballen me diskriminim gjinor dhe të shumëfishtë;
- Persona me probleme të shëndetit mendor, në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat;
- Persona me aftësi ndryshe, në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat.
- Personat që kanë dalë nga vuajtja e dënimit, në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat;
- Personat refugjatë, azilkerkues, pa dokumente, migrantë, në mënyrë të veçantë gratë dhe vajzat;

Neni 7

Kohëzgjatja

Qendra krijohet për zhvilluar veprimtarinë e saj pa afat. Kohëzgjatja mund të kufizohet me vendim të Bordit Drejtues. Përfundimi i veprimitarise së Qendrës bëhet me vendim të Bordit Drejtues ose me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë, sipas kushteve të parashikuara në nenin 44 të Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse". Personaliteti juridik i Qendrës mbaron në ditën kur vendimi i Gjykatës për çregjistrimin e saj ka marrë formë të prerë.

Neni 8

Burimet e të ardhurave dhe përdorimi i tyre

Veprimtaria e Qendrës dhe qëllimi i saj do të përbushen vetëm me fonde dhe të ardhura të siguruara nga burime të njoitura nga ligji, të cilat do të përdoren në mënyrë të ligjshme për përbushjen e qëllimit të saj.

Të ardhurat e Qendrës do te sigurohen nga :

- kontributi fillestar i themelueses, i përbërë në momentin e krijimit të saj nga një shumë prej 100.000 (njëqind mijë) lekë, shumë e cila do të kalojë në pronësi ekskluzive të Qendrës nga momenti i regjistrimit të saj në Gjykatë. Themeluesja zhvishet nga e drejta e pronësisë së kësaj shume në momentin e përcaktuar më lart;
- donacione;
- të ardhura dhe financime të ligjshme nga donatorë vendas dhe të huaj;
- dhurata, ndihma, grante, kontribute dhe sponsorizime nga persona fizike dhe juridike, vendas dhe të huaj të dhëna pa kushtëzime dhe që nuk bien ndesh me kushtet e këtij statutit dhe ligjet në fuqi;
- programet e finançuara nga organizma ndërkombëtare, organizma dhe institucione e fondacione kombëtare e të huaja, borde lokale, rajonale, kombëtare e ndërkombëtare, zhvillimi i leksioneve, ekspozitave etj;
- burime të tjera financimi, shprehimisht të lejuara prej ligjeve të Republikës së Shqipërisë.
- Qendra do të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe ka të drejtë të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe të ushtrimit të veprimtarive të tjera në përputhje me ligjin dhe qëllimin e objektin e veprimtarisë të parashikuar në statutin të saj.

Të ardhurat e siguruara nga Qendra, do të përdoren për kryerjen e shpenzimeve që lidhen vetëm me realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimitarise, për të cilin ajo është krijuar, si dhe për drejtimin e mirëmbajtjen pasurisë së saj.



Neni 9

Kriteret e administrimit të pasurisë

Administrimi i pasurive të Qendrës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe financiare mbahet bilanc i rregullt që miratohet nga Bordi Drejtues. Qendra ka llogaritë e saj bankare që çelen dhe operojnë sipas urdhërave të Drejtorit Ekzekutiv.

Bordi Drejtues dhe donatorët e mundshëm kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shpjegime rreth gjendjes financiare të Qendrës. Drejtori Ekzekutiv me stafin i japid ato brënda një afati optimal dhe nëse është e nevojshme i shoqërojnë këto shpjegime me kopjet e dokumentacionit përkatës.

Neni 10

Ndalimi i shpérndarjes së fondeve

Qendra ka vetëm dhe drejtpërdrejt qëllime jo-fitimprurëse.

Sipas Ligjit nuk lejohet asnjë formë e shpérndarjes së fitimit ose e përfitimit finansiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e organizatës jofitimprurëse prej personave që janë subjekte të statutit ose aktit themelues, përveç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të organizatës jofitimprurëse. Çdo veprim i kundërt është plotësisht i pavlefshëm dhe organet përgjegjëse mbajnë përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 11

Miratimi i rregullave të brendshme

Rregulloret e brendshme të Qendrës dhe degëve të saj, ku përcaktohen normat e funksionimit të sektorëve të ndryshëm të Qendrës, raportet me të tretet, etj. hartohen në zbërthim të Statutit dhe Aktit të Themelimit dhe miratohen nga Bordi Drejtues.

Neni 12

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese të Qendrës janë :

- Bordi Drejtues (organ vendimmarrës)
- Drejtori Ekzekutiv (organ drejtues)

Neni 13

Bordi Drejtues , përbërja

Bordi Drejtues përbëhet nga 3 anëtarë, dhe përbëhet nga shtetaset:

1. **Flutura GURI**, e dtl. 15.04.1950, lindur në Çorovodë, Skrapar dhe banuese dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Marie Kraja"; Nd. 2; H. 2; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005, me shtetësi shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) me numër personal F05415139R.

2. **Drita BABAMETO**, e dtl. 21.07.1953, lindur në Tiranë dhe banuese në dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Muhamet Gjollesha"; Nd. 64/1; H. 1; Ap. 11; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) me numër personal F35721045F.

3. **Nadia GUNI**, e dtl. 08.11.1998, lindur në Tiranë dhe banuese në banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Ali Demi"; Nd. 118; H. 12; Ap. 17; Njësia Administrative Nr. 1; Njësia Bashkiake Nr. 1; 1004, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) me numër personal J86108035S.

Anëtarët e Bordit Drejtues do të ushtrojnë kompetencat vullnetarisht sipas statutit dhe Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" për një periudhë 7 vjeçare.

Neni 14

Emërimi, largimi, shkarkimi i Bordit Drejtues

Vetëm anëtarët e parë të Bordit Drejtues janë emëruar nga themeluesit.

Anëtarët e Bordit në vazhdim të veprimtarisë së Qendrës, emërohen, largohen apo shkarkohen nga vetë Bordi.

Anëtarë i Bordit Drejtues mund të jetë çdo shtetas shqiptar ose i huaj i cili dëshiron të kontribuojë vullnetarisht për arritjen e qëllimit të veprimtarisë së Qendrës, pranon të respektojë dhe të marri përsipër detyrimet që rrjedhin nga Ligji dhe Statuti për kryerjen me përgjegjësi të detyrave.

Anëtarët e Bordit e humbasin këtë cilësi në rastet kur:

- japid dorëheqjen, në çdo formë të paraqitjes të tij përpara Bordit, me gojë ose me shkrim,
- mbaron afati i emëritit të tyre sipas statutit,
- nuk marrin pjesë deri në 3 mbledhje të Bordit,
- shkarkohen për shkelje apo mos përbushje të detyrimeve sipas Ligjit dhe Statutit,
- kur cenohet integriteti moral dhe social i tij,
- kur është subjekt i një vendimi penal.
- vdes

Anëtarët e Bordit Drejtues, emërohen, largohen apo shkarkohen nga vetë Bordi me votimin pro té 2/3 të anëtarëve të pranishëm të Bordit, pasi është plotësuar quorumi për zhvillimin e mbledhjes, pjesëmarrjes të më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij në mbledhje, procedura e thirrjes së mbledhjeve dhe vendimmarrja është parashikuar në mënyrë të hollësishme në këtë statut (nenet 20, 21, 22).

Neni 15

Kompetencat dhe detyrimet e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej tij vendos për:

- Ndryshimin e statutit;
- Përcakton fushat dhe programin e veprimtarisë së Qendrës dhe degëve të saj;
- Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e veprimtarisë;
- Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit;
- Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Qendrës dhe shpenzimet të tij;
- Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe strukturës organizative të Qendrës;
- Zgjedh, emëron, miraton largimin apo shkarkimin për anëtarët e organit vendimmarrës (Bordin Drejtues) dhe anëtarët e organit drejtues (Drejtorin Ekzekutiv);
- Krijon komitete të posaçme si dhe shqyrton çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në statut;
- Menaxhon assetet e Qendrës dhe mbikëqyr punën e tij mbi bazën e statutit për të arritur objektivat e caktuara.
- Zhvillimi i mëtejshëm konceptual i Qendrës.
- Zhvillimi i një koncepti të marketingut, veprimtaria e marrëdhënieve publike dhe sigurimi i mjeteve monetare me anë të mbledhjes së fondeve.

- Merr vendim për shpërndarjen, bashkimin ose transformimin e Qendrës në një organizatë të një forme tjeter;
- Vendos për krijimin e degëve ose filialeve në rrethe ose jashtë vendit;
- Vendos për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike nga Qendra sipas ligjit me qëllim gjenerimin e të ardhurave;
- Miraton aktivitete për mbledhjen e fondeve, sipas nenit 37 të Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”;
- Emëron likuiduesit;
- Shqyrton raportin e likuiduesve;
- Vendos për kalimin e pasurive në subjekte të tjera në rast shpërndarje të Qendrës.

Anëtari i Bordit Drejtues detyrohet:

- të respektojë dhe zbatojë me rigorozitet dispozitat e statutit dhe Rregullores së Brendshme.
- të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e Bordit duke paraqitur ide për realizimin efektiv të qëllimit të Qendrës, duke bashkëpunuar dhe mbështetur drejtorin ekzekutiv.
- të kontribuojë në të gjitha veprimtaritë, programet dhe projektet e Qendrës, me ide dhe informacion në planifikimin dhe zbatimin e tyre.
- të ruajë konfidencialitetin;
- të ketë sjellje etike dhe korrekte si në marrëdhëniet me anëtarët e tjerë dhe me të tretët dhe të ruajë e lartësojë imazhin e Qendrës.

Neni 16

Drejtori Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv drejton veprimtarinë e përditshme të Qendrës, është përfaqësues ligjor i saj në marrëdhënie me të tretët dhe ekzekuton programet e aprovuara nga Bordi Drejtues.

Drejtore Ekzekutive e Qendrës është znj. Nadia ÇOBO, e d.t. 06.03.1997, lindur në Berat, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit (ID) numër personal J75306050I, e cila do të ushtrojë detyrat sipas statutit dhe Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Per Organizatat Jofitimprurëse”.

Drejtori ekzekutiv ushtron detyrat për një periudhë 7 vjeçare.

Neni 17

Emërim, largimi, shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv

Drejtor ekzekutiv i Qendrës mund të jetë çdo shtetas i cili ka aftësi dhe ekspertizë të spikatur drejtuese, menaxhuese dhe komunikuese, pranon të respektojë dhe të marri përsipër detyrimet që rrjedhin nga Ligji dhe Statuti për kryerjen me përgjegjësi të detyrave të ngarkuara.

Bordi Drejtues vlerëson kërkesat dhe platformën drejtuese të paraqitur nga kandidatët për Drejtor Ekzekutiv, çka ai parashikon të zbatojë për përbushjen sa më efektive të qëllimit, programit dhe projekteve të Qendrës.

Drejtori Ekzekutiv e humbet këtë cilësi në rastet kur:

- jep dorëheqjen në çdo formë të paraqitjes të tij përpara Bordit, me gojë ose me shkrim,
- mbaron afati i emëritimit të tij sipas statutit,
- në rast të shkeljes ose mos përbushjes së detyrimeve sipas parashikimeve të statutit, Kodit Civil, legjislacionit të organizatave jofitimprurëse, legjislacionit tatimor, legjislacionit të parandalimit të pastrimit të parave dhe çdo akti normativ i cili rregullon ose lidhet me veprimtarinë e Shoqatës;

- Në rast të abuzimit me detyrën dhe me fondet e organizatës;
- Në rast të marrjes së vendimeve për qëllime personale;
- Kur dëmton imazhin e Qendrës nëpërmjet sjelljes së tij me anëtarët e Bordit dhe bashkëpunëtorët;
- Kur cenohet integriteti moral i tij/saj;
- Shkel parimin e konfidencialitetit;
- Ka një dënim penal të formës së prerë në ngarkim të tij;
- Kur vdes.

Emërimi në detyrë dhe largimi nga detyra i Drejtorit ekzekutiv bëhet me vendim të Bordit Drejtues, me votimin pro të 2/3 të anëtarëve të pranishëm të Bordit, pasi është plotësuar quorumi për zhvillimin e mbledhjes, pjesëmarrjes të më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij në mbledhje, procedura e thirrjes së mbledhjeve dhe vendimmarrja është parashikuar në mënyrë të hollësishme në këtë statut (nenet 20, 21, 22).

Përpara largimit nga detyra, Drejtori Ekzekutiv duhet të dorëzojë të inventarizuar gjithë dokumentacionit ligjor, financiar, dhe mjetet e luajtshme në ngarkim të tij gjatë ushtrimit të detyrës, kodet e aplikueshme në portalin e-albania, QKB, tatime, si edhe një raport përbledhës për situatën financiare të Qendrës duke përfshirë çdo rubrikë në të dhe një analizë të hollësishme të realizimit ose jo të projekteve që organizata ka në zbatim në atë periudhë.

Në rast të shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv, zgjedhja e Drejtorit të ri të Qendrës nuk mund të zgjasë më shumë se 30 ditë.

Neni 18

Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv ka këto kompetenca gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij:

- Administrimin e veprimtarisë së përditshme të Qendrës, në zbatim të statutit, vendimeve të Bordit Drejtues dhe legjislacionit në fuqi;
- Është përfaqësues ligjor i Qendrës.
- Siguron mbarëvajtjen financiare të Qendrës dhe ushtrimin e veprimtarisë së saj në përputhje me ligjin dhe qëllimin e deklaruar.
- Përfaqëson organizatën në marrëdhënie me subjektet, private ose publike, të tilla si donatorë, klientë furnizues apo subjekte të tjera private, organizata ndërkombëtare, Banka të të gjitha niveleve, Zyra të Tatim Taksave, Doganave, si edhe me të gjitha nivelet e qeverisjes që rregullojnë veprimtarinë e saj.
- Menaxhon dhe vepron për llogari të Qendrës, nëpërmjet llogarive bankare të saj në Banka të nivelit të dytë, duke përfshirë këtu, pagesa në favor të të tretëve, tërheqje shumash të ndryshme, kryerje transfertash dhe çdo veprim tjetër i cili do të vlerësohet i nevojshëm për veprimtarinë normale të organizatës.
- Mbikqyr menaxhimin dhe administrimin e të gjitha aseteve dhe burimeve financiare të Qendrës dhe raporton për punën e tij përpëra Bordit.
- Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste.
- Realizon dhe ekzekuton programet e vendosura nga Bordi Drejtues, organi më i lartë vendimmarrës;
- Përgatit projekt programin vjetor të veprimtarive dhe projekt buxhetin e Qendrës, te cilat ia paraqet për miratim Bordit Drejtues dhe më pas kontrollon zbatimin e tyre;
- Përgatit të gjitha materialet dhe njoftimet për mbledhjet e Bordit.

- Emëron stafin sipas strukturës dhe kriterieve të miratuar nga Bordi si edhe lidh kontratat e punës me stafin në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës;
- Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë tju delegojë kompetencat e tij sipas statutit dhe ligjit, personave të tretë me miratimin e Bordit.
- siguron mbarëvajtjen financiare të organizatës dhe ushtrimin e veprimtarisë së saj në përputhje me qëllimin e deklaruar;

Neni 19

Shkeljet e rënda

Konsiderohen shkelje të rënda:

- Përfitimi i paligjshëm nga Anëtari i Bordit Drejtues apo Drejtorit Ekzekutiv të fondeve që janë në pronësi, apo kujdestari të Qendrës;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve që sjellin detyrime për Qendrën pa dijeni të Organit vendimmarrës;
- Përdorimi abuziv i fondeve të Qendrës, apo dhënia e autorizimit në çfarëdo mënyre për një përdorim të tillë.
- Dëmtimi i imazhit të Qendrës nëpërmjet veprimeve që shkelin etikën qytetare dhe çdo veprim që bie ndesh me filozofinë, misionin, qëllimet dhe punën e Qendrës;

Anëtari i Bordit Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv që ka shkelur rëndë statutin, përveç përashtimit nga funksionet mund të detyrohet të dëmshpërblejë Qendrën për pasojat dhe dëmet që kanë sjellë këto shkelje.

Neni 20

Rregullat për mbajtjen e mbledhjeve

Bordi Drejtues mblidhet të paktën dy herë në vit. Mbledhja e Bordit Drejtues thirret me kërkesë të Drejtorit Ekzekutiv ose me kërkesë të 1/3 së anëtarëve të Bordit Drejtues. Mbledhja njoftohet me shkrim, me postë zyrtare ose me postë elektronike, të paktën 7 ditë përpara mbledhjes, duke bërë të ditur datën, orën, vendin e zhvillimit të tij, rendin e ditës dhe materialet për diskutim.

Neni 21

Pjesëmarrja

Mbledhja e Bordit Drejtues, për të gjitha çështjet që merr në shqyrtim (ndryshimin e statutit, aktit të themelimit, ndryshim selie, ndryshim emri, shtimin e qëllimit të veprimtarisë, emërim, largim apo shkarkim të drejtorit ekzekutiv, emërim, largim apo shkarkim të anëtarëve të Bordit Drejtues, likuidimin, ndarjen, bashkimin, transformimin e Qendrës, etj.) është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Anëtarët e Bordit marrin pjesë në mbledhje edhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, video konferanca nëpërmjet skype apo mënyra të tjera, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e tyre. Anëtarët e Bordit marrin pjesë në mbledhje personalisht ose të përfaqësuar me prokurë nga një person i ngarkuar prej tij.

Neni 22

Vendimmarria

Vendimet e Bordit Drejtues, për të gjitha çështjet e marra në shqyrtim (ndryshimin e statutit, aktit të themelimit, ndryshim selie, ndryshim emri, shtimin e qëllimit të veprimtarisë, emërim, largim apo shkarkim të Drejtorit Ekzekutiv, emërim, largim apo shkarkim të anëtarëve të Bordit Drejtues, likuidimin, ndarjen, bashkimin, transformimin e Qendrës, etj.) merren me votën pro të 2/3 të anëtarëve të pranishëm të Bordit, pas plotësimit të quorumit për zhvillimin të tij sipas nenit 21 të statutit. Votimi është i fshehtë, përveç rasteve të veçanta kur Bordi Drejtues mund të vendosë ndryshe.

Pas verifikimit të pjesëmarrjes në mbledhje, Bordi zgjedh kryetarin i cili drejton mbledhjen, dhe sekretarin i cili mban procesverbalin të tij, i cili mund të jetë një nga anëtarët ose një punonjës i stafit administrativ.

Çdo vendim i Bordit Drejtues nënshkruhet nga anëtarët e Bordit prezent në mbledhje ndërsa procesverbalet përkatëse të mbledhjeve nënshkruhen nga Kryetari dhe sekretari i mbledhjes së Bordit. Prosesverbalet janë akte të cilat duhet të mbahen në ruajtje në arkivën dokumentare të Qendrës.

Vendimet e Bordit Drejtues të cilat përbajnë ndryshime të statutit apo aktit të themelimit, duhet të depozitoohen brenda 30 ditëve pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë në Zyrën e Regjistratës Organizatave Jofitimprurëse për t'u reflektuar këto ndryshime në aktet e organizatës.

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të Procesverbaleve dhe vendimeve përkatëse.

Neni 23

Bashkimi, transformimi dhe ndarja e Qendrës

Qendra me propozim të Drejtorit Ekzekutiv dhe miratimin e dhënë nga anëtarët e Bordit Drejtues, për arsyen e lehtësirave që mund të krijohen nga bashkëpunimi gjithmonë në të mirë të arritjes së objektivave të Qendrës, mund të bashkohet, ndahet ose të transformohet me organizata të tjera jofitimprurëse pa anëtarësi. Qendra konsiderohet e shpërndarë me regjistrimin e subjektit të ri.

Neni 24

Vetshpérndarja

Qendra shpërndahet me iniciativën të saj, kur qëllimi i saj është përmbushur apo nuk ka mundësi të përmbushet.

Neni 25

Norme

Gjykata mund të vendllojë shpërndarjen e Qendrës me kërkesë të organit të saj vendimmarrës, të organit shtetëror kompetent në rastet kur:

- a) veprimtaria të saj vjen në kundërshtim me Kushtetutën;
 - b) kryen veprimtari të kundërligjshme;
 - c) nuk është themeluar sipas kërkesave të ligjit;
 - c) ka falimentuar sipas ligjit për falimentimin.

Përveç rasteve kur veprimtaria e saj përbën kërcënëm serioz për publikun, gjykata duhet të lajmërojë me shkrim organizatën për shkeljen e ligjit dhe t'i japë 30 ditë për të korriguar veprimtarinë e saj.

Nenj 26

Likuidimi

Kur vendoset shpërndarja e Qendrës, Bordi Drejtues cakton një ose disa likuidues të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi asetat, pasuritë dhe përfaqësimin e Qendrës që nga data e emërimit të tyre e deri në përfundim të likuidimit.

Likuiduesit e kryejnë veprimtarinë e tyre në bazë të nenit 47 të Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat joftimprurëse” dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Me emërimin e likuiduesit ose të likuiduesve, Drejtori Ekzekutiv nuk ka më funksione.

Kur shpërndarja e Qendrës vendoset me vullnet të lirë të Bordit Drejtues, ky organ kontrollon dhe miraton përfundimisht procedurat e likuidimit, miraton reportin përfundimtar të likuiduesit dhe i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë me kërkesë për çregjistrimin e Qendrës. Nëse reporti përfundimtar i likuiduesve nuk miratohet nga Bordi

Drejtues shqyrtohet nga Gjykata në prani të palëve. Likuiduesi ose likuiduesit emërohen me vendim të Bordit Drejtues.

Neni 27

Veprimtaria e likuiduesve

Likuiduesi ose likuiduesit, brenda dy muajve nga data e emërimit të tyre thërret mbledhjen e Bordit Drejtues, të cilit i paraqet raportin mbi gjendjen financiare të Qendrës, aktivin dhe pasivin e saj, para se të fillojë operacioni i likuidimit.

Likuiduesi përfaqëson Qendrën dhe ka të gjitha kompetencat e nevojshme për likuidimin e pasivit të saj. Likuiduesi është i autorizuar të paguajë të gjithë kreditorët dhe më pas vlerëson pasurinë e mbetur dhe kujdeset që kjo pasuri të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga statuti.

Neni 28

Destinimi i pasurisë pas shpërndarjes së Qendrës

Pasuria e Qendrës pas shpërndarjes të saj, do të destinohet sipas vendimit të Bordit Drejtues.

Neni 29

Dispozita tranzitore

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin midis anëtarëve të Bordit Drejtues apo me strukturë të tjera të Qendrës do të bëhen përpjekje që të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre. Në të kundërt ato do t'i shtrohen për zgjidhje Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridikzionit të Përgjithshëm Tiranë.


Neni 30

Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të RSH, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” i ndryshuar, Ligjit nr. 8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” i ndryshuar.

Ky statut i Qendrës “BARAZI DHE PËRFSHIRJE”, u hartua në gjuhën shqipe, në katër ekzemplarë origjinale, me vlerë të njëjtë juridike.

Statuti nënshkruhet me vullnet të plotë e të lirë nga themelueses së Qendrës.

THEMELUESE


Nadia COBO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELONA L. SALIAJ
ADRESA Blv. "Bajram Curri", pallatet
"1 Maj", shkalla nr. 9, kati parë
TEL: 692816131

VËRTETIM NËNSHKRIMI



Nr. repertori: 449

Tirane më 16/05/2024

Ligjet referuese:

- 1.Liqji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Liqji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Liqji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2024051780026693004

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ELONA L. SALIAJ



V202405178002693004



DATE 16/05/2024
NR REP 449

VËRTETIM NËNSHKRIMI
STATUT I QENDRËS “BARAZI DHE PËRFSHIRJE”

Sot më datë 16 Maj 2024 (*dymijë e njëzet e katër*), ditë e Enjte, para meje Notere Elona L. SALIAJ, Anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me Zyrë Rr. “B. Curri”, Pallatet “1 Maji”, shkalla nr. 9, kati 1, u paraqit personalisht:

KËRKUESE:

Znj. Nadia ÇOBO, atësia Kujtim, amësia Miranda, me shtetësi shqiptare, lindur në Berat dhe banuese në Berat, me adresë Muzhakaj 00010335; Nd. 14; H. 1; 5001; e datëlindjes 06.03.1997, mëdhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garanjoval me letërnjoftim ID nr. 039256092 dhe nr. personal J75306050I.

Shtetasja e mësipërme, në cilësinë e themelueses së “Barazi dhe Përfshirje” dhe në anglisht “Center for Equality and Inclusion”; në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, dokumentin e sipërcituar **Statut i qendrës “Barazi dhe Përfshirje”** dhe në anglisht “Center for Equality and Inclusion”, datë 16 Maj 2024, të hartuar në gjuhën Shqipe, jashtë zyrës Notoriale, e përbërë nga 11 (njëmbëdhjetë) fletë, **dhe e nënshkruar prej saj sot më datë 16 Maj 2024, përpara meje Noteres**, të cilës i bashkëlidhet ky vërtetim nënshkrimi.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet dokumenteve të identitetit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë “ë”, neni 100, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr. 23, datë 7.12.2020; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënavë Personale”, i ndryshuar, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

N O T E R E
Elona L. SALIAJ



